



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale/ Agencija za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa/ Agency for the Management of Monuments and Memorial Complexes

DATË/A:	15.04.2025
REFERENC-Ë:	49/04/25
PËR/ZA/TO:	Agim Krasniqi/ Drejtor i DQH - MFPT
CC:	Musa Islami/ Zyrtar i NJQH/DQP - MFPT
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Imer Hakaj/ Zv. Drejtor Ekzekutiv i AMMKM -së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Raporti Vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të AMMKM-së.



Të nderuar,

Në bazë të Ligjit nr. 06/L-21, përmes kësaj shkrese ju dërgojmë Raportin e Vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Raportin Vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të AMMKM-së.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale/ Agencija za Upravljanje Spomenika i Memorijalnih Kompleksa/ Agency for the Management of Monuments and Memorial Complexes

**RAPORTI VJETOR PËR SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË
AGJENCINË PËR MENAXHIMIN E MONUMENTEVE DHE KOMPLEKSEVE
MEMORIALE**

Prill, 2025

Përmbajtja:

1. Lista e shkurtesave.....	1
2. Vlerësimi i përgjithshëm i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm	2
2.1 Gjendja e aktuale në fushën të MKF-së.....	4
3. Plani i veprimit për adresimin e dobësive të identifikuara të SKB-së dhe rekomandimeve të auditorëve.	6
4. Deklarata e Kontrollit të Brendshëm (<i>shih më poshtë</i>)	7
5. Pyetësi vetë vlerësues me përgjigje.....	10

MF - Ministria e Financave

NjQH/MFK - Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhim Financiar dhe Kontroll

KBFP – Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike

MFK – Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

COSO – Komiteti i Organizatave Sponzoruese të Komisionit Treadëay

INTOSAI -

AB - Auditorët e Brendshëm

AJ - Auditimi i Jashtëm

KA - Komiteti i Auditimit

LAB - Ligji për Auditim të Brendshëm

KAB – Korniza Afatmesme Buxhetore

KASH- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

MSHP – Menaxhimi i Shpenzimeve Publike

MSP – Menaxhimi i Sistemit të Pagave

NjQH – Njësia Qendrore Harmonizuese

PIP – Programi i Investimeve Publike

SIMFK – Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar të Kosovës

SIMBJ – Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

SIP – Sistemi Informatik i Pagave

SSP- Subjekti i Sektorit Publik

SMVP – Sistemi i Menaxhimit të Vljueshmërisë së Punës

SZHMB – Sistemi i Zhvillimit për Menaxhimin e Buxhetit (BDMS)

1. Vlerësimi i përgjithshëm i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

1. Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të SSP-së, bazuar në rezultate e monitorimit (vetëvlerësimi) të përshkruara në nenin 15 dhe 16 të Ligjit për KBFP dhe rezultatet e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zytari Kryesor Administrativ në lidhje me funksionimin e MFK

Sipas Neni 4 të LKBFP paragrafi 1, pika 1 deri 9 janë¹ Llogaridhënia menaxheriale e Zytari Kryesor Administrativ kanë të bëjë;

Vendosja e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Subjekt, hartimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe që ndërlidhen me zbatimin e tyre.

Zytari Kryesor Administrativ e siguron:

- burime adekuate dhe ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efikase dhe efektive; besueshmërinë, rëndësinë dhe integritetin e informatave; përmbushjen e obligimeve të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme; zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore;
- përcaktimin e strukturës adekuate organizative, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për vendimmarrje, realizim, kontroll dhe monitorim të arritjes së objektivave të Subjekti në të gjitha programet;
- vendosjen e sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe zbatimin e veprimeve për zvogëlimin e rrezikut në mënyrë që të arrihen objektivat e Subjektit;
- themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë së tij funksionale, përmbushjen e kriterëve tjera për qeverisje të mirë publike, përfshirë përgatitjen dhe zbatimin e politikave, buxhetimin adekuat dhe qëndrueshmërinë financiare.

1.1. Buxheti i Subjektit

Ligji i buxhetit Ligji Nr. 08/L-260 për vitin 2024 ka përcaktuar shumat e lejuara dhe ka venë në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës për gjithë sektorin publik dhe për Subjektin tonë (AMMKM) në vlerë 6,297,168.00€ nga Buxheti i Kosovës. Buxheti final me Vendime të Qeverisë, për AMMKM ka qenë 4,797,126.99€. Donacion i brendshëm nga Fondacioni Labinot Tahiri, kemi pranuar në vitin 2020 dhe i bartur në vitin 2024 me vlerë 5,000.00€

Lidhje me PVF Zyra kombëtare e Auditimit për vitin 2023 është Opinion i Pa –modifikuar.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

1.2 Gjetjet kryesore (gjendja aktuale në fushën e MFK-së në SSP)

Sipas të dhënave gjatë monitorimit, monitorimit, por edhe raportin e ZKA (Zyra kombëtare e auditimit) për vitin 2023 edhe gjatë vitit 2024 e deri në kohën e monitorimit kemi një progres premtues.

Por për shkak të përcaktimit të prioritetëve të Qeverisë për rritje të buxhetit në investime kapitale e jo në mallra e shërbime, implementimi dhe efekti i masave të ndërmarra mbetet të shihen në të ardhmen sepse disa veprime janë të kushtëzuara nga cikli buxhetor i propozuar nga Qeveria dhe miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

¹ Interpretimi i përgjegjësi është bërë i në kontestin e përgjegjësi të Zytari Kryesor Administrativ

Për shkak të mos shpronësimit të pronave në disa komplekse memoriale dhe mos caktimi i lokacioneve nga komunat për ndërtim të komplekseve ka ndikuar në shkurtime të buxhetit, kursime, me Vendime të Qeverisë dhe ndarje të buxhetit për shkak të obligimeve të krijuara. Kjo ka ndikuar që planifikimi fillestar ka qenë vështirë i realizueshëm dhe ka ndikuar në mos iniciimin e realizimit të projekteve të reja.

Gjatë auditimit për vitin 2023 kemi një të gjetur, i zbatuar në vitin 2024 dhe tutje.

1. Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të siguroj një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave/shkëputjeve të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.

ZKA i AMMKM-së, por jo vetëm ai por i gjithë stafi i AMMKM-së, ndihen të sfiduar se si të menaxhohet situata terren për shkak të kushteve atmosferike dhe ngjarjeve tjera të papritura gjatë punimeve kanë ndodhur vonesat në punime. Por AMMKM në çdo rast të vonesave ka shqiptuar dënimet sipas legjislacionit në fuqi.

Një menaxhimi efektiv, nënkupton përmbushjen e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm dhe AB.

AMMKM ka pasur një rekomandim të dhënë nga Auditori i Jashtëm.

Meqenëse AMMKM është njësi vartëse e MKRS-së, Auditimin e Brendshëm të AMMKM duhet ta kryej Njësia e Auditimit të MKRS-së.

AMMKM ka përgatitur listën e rreziqeve e cila ishte bazuar në SWOT analizë, menaxherët e linjës kishin dhënë inputet e tyre, e njëjta gjatë vitit ishte rishikuar nga menaxhmenti për efektivitet në vitin vijues.

AMMKM ka zbatuar pajtueshmërinë e ligjeve në fushën e prokurimit publik.

Dokumentet strategjike të AMMKM-së janë në hartim e sipër, ndërsa Raportet Financiare janë të publikuara në web faqe.

AMMKM është në proces të hartimit të Strategjisë së Zhvillimit dhe gjatë vitit 2025 pritet të përfundohej.

Kornizën afatmesme të shpenzimeve AMMKM e harton çdo vit në bazë të prioritetëve për ndërtimin e Memorialeve dhe Komplekseve sipas Ligjit për Agjencinë si dhe bazuar në planet vjetore.

2. Plani i veprimit për adresimin e dobësive të identifikuara të SKB-së dhe rekomandimeve të auditorëve.

Subjekti i Sektorit Publik ka të vendosura kontrollet për MFK të cilat funksionojnë dhe janë duke u përmirësuar vazhdimisht kjo dëshmohet me libri i përshkrimit të proceseve për shpenzimet etj.

3. Data dhe nënshkrimi i Udhëheqësit të SSP-së

(Nënshkrimi i Zyrtarit Kryesor
Administrativ të SSP dhe vula)



Në vazhdim janë :

1. Deklarata e Kontrollit të Brendshëm (*shih më poshtë*)
2. Pyetësi vetë vlerësues me përgjigje

I. Deklarata e Kontrollit të Brendshëm

Fusha e përgjegjësisë

Si Zyrtar Përgjegjës, unë kam përgjegjësinë që të mbaj një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit i cili mbështet realizimin e politikave, synimeve dhe objektivave të organizatës të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës, duke ruajtur në të njëjtën kohë fondet dhe asetet publike për të cilat unë jam personalisht përgjegjës, në pajtim me përgjegjësitë që më janë caktuar mua.

Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të SSP-së, bazuar në rezultatet e monitorimit (vetëvlerësimit) të përshkruara në nenin 15 dhe 16 të Ligjit për KBFP dhe rezultatet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zytari Kryesor Administrativ (Kryetarit të Komunës) lidhje me funksionimin e MFK

Sipas Neni 4 të LKBFP paragrafi 1, pika 1 deri 9 janë² Llogaridhënia menaxheriale e Zytari Kryesor Administrativ (kryetarit të Komunës) kanë të bëjë;

Vendosja e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit nesubjekt, hartimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe që ndërlidhen me zbatimin e tyre.

Zyrtari Kryesor Administrativ i siguron:

- burime adekuate dhe ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efikase dhe efektive; besueshmërinë, rëndësinë dhe integritetin e informatave; përmbushjen e obligimeve të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme; zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore;
- përcaktimin e strukturës adekuate organizative, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për vendimmarrje, realizim, kontroll dhe monitorim të arritjes së objektivave të Subjektit në të gjitha programet;
- vendosjen e sistemit të menaxhimit të rrezikut dhe zbatimin e veprimeve për zvogëlimin e rrezikut në mënyrë që të arrihen objektivat e Subjektit;
- themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe garantimin e pavarësisë së tij funksionale, përmbushjen e kriterëve tjerë për qeverisje të mirë publike, përfshirë përgatitjen dhe zbatimin e politikave, buxhetimin adekuat dhe qëndrueshmërinë financiare.

Qëllimi i Menaxhimit Financiar

Menaxhimi financiar ka të bëjë me forcimin e performancës së një organizate për të siguruar një vendimmarrje më të mirë, shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paratë.

² Inerpertimi i përgjegjësi është bërë i në kontestin e përgjegjësi të Zytari Kryesor Administrativ

Menaxhimi financiar bazohet në premisën se menaxhmenti është përgjegjës jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare por edhe për tu siguruar që ato vendime të merren si duhet dhe të jenë në interesin më të mirë të publikut. Kjo nënkupton edhe sigurimin që resurset, d.m.th., stafi, asetet dhe buxhetet përdoren në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike.

Menaxhimi financiar përfshinë planifikimin e punës dhe atë financiar, buxhetimin dhe raportimin dhe përfshinë parimet e transparencës dhe llogaridhënies përmes të cilave individët e pranojnë përgjegjësinë për veprimet e tyre.

Ligji i buxhetit Ligji Nr. 08/L-260 për vitin 2024 ka përcaktuar shumat e lejuara dhe ka venë në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Kosovës për gjithë sektorin publik dhe për Subjektin tonë (AMMKM) në vlerë 6,297,168.00€ nga Buxheti i Kosovës. Buxheti final me Vendime të Qeverisë, për AMMKM ka qenë 4,797,126.99€. Donacion i brendshëm nga Fondacioni Labinot Tahiri, kemi pranuar në vitin 2020 dhe i bartur në vitin 2024 me vlerë 5,000.00€
Lidhje me PVF Zyra kombëtare e Auditimit për vitin 2023 është Opinion i Pa –modifikuar.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Sipas të dhënave gjatë monitorimit, monitorimit, por edhe raportin e ZKA (Zyra kombëtare e auditimit) për vitin 2023 edhe gjatë vitit 2024 e deri në kohën e monitorimit kemi një progres premtues.

Por për shkak të përcaktimit të prioriteteve të Qeverisë për rritje të buxhetit në investime kapitale e jo në mallra e shërbime, implementimi dhe efekti i masave të ndërmarra mbetet të shihen në të ardhmen sepse disa veprime janë të kushtëzuara nga cikli buxhetor i propozuar nga Qeveria dhe miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Për shkak të mos shpronësimit të pronave në disa komplekse memoriale dhe mos caktimi i lokacioneve nga komunat për ndërtim të komplekseve ka ndikuar në shkurtime të buxhetit, kursime, me Vendime të Qeverisë dhe ndarje të buxhetit për shkak të obligimeve të krijuara. Kjo ka ndikuar që planifikimi fillestar ka qenë vështirë i realizueshëm dhe ka ndikuar në mos iniciimin e realizimit të projekteve të reja.

Ministri përmes zyrtarëve përgjegjës duhet të siguroj një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të filluara dhe të identifikojë arsyet e vonesave/shkëputjeve të kontratave dhe marrjen e veprimeve për realizimin/përfundimin e tyre.

ZKA i AMMKM-së, por jo vetëm ai por i gjithë stafi i AMMKM-së, ndihen të sfiduar se si të menaxhohet situata në terren për shkak të kushteve atmosferike dhe ngjarjeve tjera të papritura gjatë punimeve, kanë ndodhur vonesat në punime. Por, AMMKM në çdo rast të vonesave ka shqiptuar dënimet sipas legjislacionit në fuqi.

Një menaxhim efektiv, nënkupton përmbushjen e rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm dhe AB.

AMMKM ka pasur një rekomandim të dhënë nga Auditori i Jashtëm.

Meqenëse AMMKM është njësi vartëse e MKRS-së, Auditimin e Brendshëm të AMMKM duhet ta kryej Njësia e Auditimit të MKRS-së.

AMKMK ka përgatitur listën e rreziqeve e cila ishte bazuar në SWOT analizë, menaxherët e linjës kishin dhënë inputet e tyre, e njëjta gjatë vitit ishte rishikuar nga menaxhmenti për efektivitet në vitin vijues.

AMKMK ka zbatuar pajtueshmërinë e ligjeve në fushën e prokurimit publik.

Menaxhimi financiar brenda organizatës është në pajtim me udhëzimet e përcaktuara në Rregullën e Menaxhimit financiar dhe kontroll dhe Manualin e Procedurave të MFK-së dhe ka ekzistuar për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor dhe deri në datën e aprovimit të raporteve dhe llogarive vjetore.

Qëllimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm është i dizajnuar që të menaxhojë e jo të eliminojë rrezikun dështimit në realizimin e politikave, qëllimeve dhe objektivave të organizatës. Prandaj ai mund të jap siguri të arsyeshme dhe jo absolute të efektivitetit.

Sistemi i kontrollit të brendshëm bazohet në një proces të vazhdueshëm të dizajnuar për identifikimin e rreziqeve kryesore për arritjen e politikave, qëllimeve dhe objektivave të organizatës; për të vlerësuar natyrën dhe përmasën e atyre rreziqeve dhe për të menaxhuar atë në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike.

Procesi brenda organizatës është në pajtim me udhëzimet e përcaktuara në Rregullën dhe Manualin e Procedurave të MFK-së dhe ka ekzistuar për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor dhe deri në datën e aprovimit të raportit dhe llogarive vjetore.

Rreziku dhe korniza e kontrollit

Të gjitha organizatat buxhetore duhet të operojnë një sistem të menaxhimit të rrezikut në pajtim me udhëzimet e përcaktuara në Procedurën Nr. 4 të Manualit të MFK-së.

Elementet kyçe të sistemit të menaxhimit të rrezikut përfshirë edhe mënyrën në të cilën identifikohet, vlerësohet dhe kontrollohet rreziku.

AMKMK ka përgatitur listën e rreziqeve e cila ishte bazuar në SWOT analizë, menaxherët e linjës kanë dhënë inputet e tyre, e njëjta gjatë vitit është rishikuar nga menaxhmenti për efektivitet në vitin vijues.

Në aspektin më të përgjithshëm organizata është e përkushtuar për procesin e zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm; zhvillimin e sistemeve në përgjigje të çdo shqyrtimi dhe zhvillimi të rëndësishëm në fushën e menaxhimit të rrezikut. Në veçanti, në periudhën që mbulon vitin deri me 31 dhjetor dhe deri në nënshkrimin e llogarive organizata ka:

AMMK nga e ka njësinë e Auditimit të Brendshëm por si Agjenci Ekzekutive e MKRS, AB planifikohet të kryhet nga njësia e Auditimit të MKRS-së.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, Zyra kombëtare e Auditimit nuk ka shpalosë ekzistencën e një dobësie të kontrollit të brendshëm.

Shqyrtimi i efektivitetit

Si Zyrtar Përgjegjës unë e kam përgjegjësinë për shqyrtimin e efektivitetit të sistemit të MFK-së. Shqyrtimi im është informuar nga:

- Lista kontrolluese e vetëvlerësimit e plotësuar nga drejtuesit brenda organizatës të cilët kanë përgjegjësinë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e MFK-së;

(Nënshkrimi i Zyrtares Kryesore
Administrative të SSP dhe vula)



II. Pyetësi vetë vlerësues

Rezultatet e Pyetësit vetë vlerësues (PVV)

Komponenti	Viti	TOTAL Poena	NR i Pergjigjeve	Mesatarja
Komponenti 1 - Mjedisi i Kontrollit	2024	46	110	2.39
Komponenti 2 - Menaxhimi i Riskut	2024	13	36	2.77
Komponenti 3 - Aktivitetet e Kontrollit	2024	27	76	2.81
Komponenti 4 - Informata dhe komunikimi	2024	11	29	2.64
Komponenti 5 – Aktivitetet e monitorimit	2024	9	21	2.33
	Total:	106	272	2.59



Republika e Kosovës
**Ministria e Financave
Punës dhe Transfereve**

PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT TË KOMPONENTËVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK)

Numri Unik i Raportit:	1183
Organizata Buxhetore:	Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK)
Vlera e Buxhetit nga Buxheti i Kosovës:	0.00 €
Vlera e Buxhetit nga burime të tjera (Donacione)	0.00 €
Zyrtari Kryesor Administrativ:	Imer Hakaj
Pozicioni në organizatë:	ZKA
Numri i njëslve të kontrolluara nga OB (njësi vartëse, zyra, agjensi, kompani publike):	
Adresa e faqes së internetit (ku gjendet e afishuar organigrama e OB):	
e-mail:	Imer.Hakaj@rks-gov.net
Telefoni:	
Periudha e raportimit, nënkupton periudhën:	Viti: 2024 - (Janar 2024 -Janar 2025)

Komponenti 1 - Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit është komponenti bazë i organizatës pasi lidhet me rregullat kryesore të funksionimit të brendshëm si: objektivat strategjike, rregulloret e brendshme, strukturat organizative, politikat e burimeve njerëzore, etj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Përgjigjet: 46, Poenat: 110, Mesatarja: 2.39

Parimi 1 - Zotimi për integritet dhe vlerat etike

Pyetja: 1	A ka subjekti Juaj rregullore të brendshme/ kod të mirësjelljes për përkufizim të situatave të konflikteve të interesit të hartuar në pajtim me ligjet relevante? (Nëse po, luteni të jepni Nr. dhe datën e miratimit të aktit nga Kryesuesi i Subjektit. Nëse jo, kur parashikohet të kryhet?) Lloji i Vlerësimit I - AMMKM aplikon legjislacionin fuqi -Ligji 06/L-011 Per Parandalimin e Konfliktit te Interesit	2
Pyetja: 2	A komunikohen apo njihen rregullisht punonjësit e subjektit me ligjet apo rregulloret e mësipërme? (mënyrë e kombinuar p.sh Komunikimi ka të bëjë me faktin që ligjet apo rregulloret afishohen në vende të dukshme për zyrtaret dhe nëse departamenti i burimeve njerëzore të ju përcjell në mënyrë elektronike KE zyrtarëve; Njohja ka të bëjë me faktin që organizohen takime/trajnime të zyrtarëve për këtë qëllim minimal 1 herë në vit.) Nëse po, jepni mënyrën e përdorur dhe specifikoni datën e dokumentit elektronik, proces verbalit të mbledhjeve apo trajnimit të organizuar. Nëse jo, kur parashikohet të kryhet? Lloji i Vlerësimit I. Vlerësohet 2 pike komunikimi i pa kombinuar - Komunikimi behet ne menyre elektronike si dhe ne takimet e rregullta javore te stafit.	2
Pyetja: 3	A ka ndonjë procedurë për raportimin e shkeljeve të rregullave mbi etikën dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj? (Nëse po, lutemi shpjegoni në rubrikën "Komente" dhe specifikoni titullin dhe datën e miratimit të kësaj procedure). Nëse jo, ose është në proces kur parashikohet të kryhet? Lloji i Vlerësimit I - Nuka ka pasur shkelje te rregullave mbi etiken. Zbatohen procedurat e legjislacionit ne fuqi.	3
Pyetja: 4	A keni ndërmarrë veprime/masa administrative për rastet e raportuara të shkeljeve (për veprim apo mosveprim) të procedurave të etikës, konfliktit të interesit brenda subjektit ? Nëse po, luteni të jepni llojin dhe datën e masave të marra. Lloji i Vlerësimit I - Nuk kemi pasur asnje rast te raportuar.	3
Pyetja: 5	Menaxheri i personelit a e monitoron pajtueshmërinë e punonjësve me Kodin e mirësjelljes dhe a ka vartësi direkt nga ZKA? (menaxheri i personelit e dëshmon këtë me dosje për çdo zyrtar) Lloji i Vlerësimit I. Vlerësimi me 2 pike nëse nuk ka vartësi direkt - Po ben monitorimin ne pajtushmeri me legjislacionin ne fuqi. Menaxheri i personelit ka vartesi direkte nga ZKA.	3

Parimi 2 – Ushtrimi i përgjegjësisë për mbikëqyrje

Pyetja: 6	Nëse keni agjensione dhe ose njësi vartësie: A merrni raportime të rregullta nga kryesuesi i agjencionit /njësisë për performancën (përbushjen e detyrave) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre? (Në rubrikën komente vendosni nr. dhe datën e disa raporteve zyrtare të marra gjatë vitit si dhe numrin e agjensioneve dhe njësive që janë nën kontrollin e SSP. Lloji i Vlerësimit I . Vlerësimi me 2 pike nëse ka vetëm raport vjetor. Nëse për SSP nuk është e aplikueshme vendosni 0 pike) - Nuk kemi agjensione apo njesi vartese.	0
Pyetja: 7	A merr Kryesuesi i Subjektit opinionin mbi performancën e organizatës në mënyrë të pavarur nga menaxhimi? (Nëse PO ka në dispozicion edhe opinione/raporte nga auditimi i brendshëm, auditimi i jashtëm apo nga organizata tjera ndërkombëtare). Lloji i Vlerësimit II	3

- Po nga Zyra kombetare e auditimit.

Pyetja: 8 Nëse keni ndërmarrje publike: A merrni raportime të rregullta nga Bordet e kompanive për performancën e kompanive dhe vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre? (Në rubrikën komente vendosni nr. dhe datën e disa raporteve zyrtare të marra gjatë vitit si dhe numrin e ndërmarrjeve që janë nën kontrollin e SSP. Lloji i Vlerësimit I . Vlerësimi me 2 pike nëse ka vetëm raport vjetor. Nëse për SSP nuk është e aplikueshme vendosni 0)

- Nuk kemi.

0

Parimi 3 – Vendosja e objektivave strategjike dhe strukturës organizative

Pyetja: 9 A keni hartuar dhe miratuar Deklaratën e Misionit të SSP që mbulon? Normalisht misioni përcaktohet me krijimin e subjektit nëpërmjet aktit ligjor dhe/ose statut. (Nëse po, lutemi specifikoni tek rubrika "Komente", datën e miratimit të saj nga Kryesuesi i Subjektit). Lloji i Vlerësimit I

- Jemi ne proces te hartimit te strategjise.

2

Pyetja: 10 A keni përgatitur dhe miratuar planin strategjik të SSP? Nëse PO: për çfarë periudhe kohore? (Si rregull planet strategjike hartohen për një periudhe mbi 3 vite. Jepni referencat e aktit të miratuar (Lloji i aktit, Nr. date) Lloji i Vlerësimit I

- AMMKM eshte ne proces te hartimit te strategjise se institucionit.

2

Pyetja: 11 Cilat departamente në SSP janë përgjegjëse për koordinimin dhe zhvillimin e planit strategjik? (në përgjigje të jepet edhe Nr. Data e rregullores së brendshme/përshkrim pune/ akt autorizimi ku është përshkruar funksioni i departamentit) Lloji i Vlerësimit I . Vlerësimi me 2 pike nëse aktet janë në proces miratimi

- DFSHP ne baze te detyrave dhe pergjegjesive.

2

Pyetja: 12 Varësisht prej llojit të subjektit. A janë përfshirë menaxherët e strukturave/ agjensioneve /njësive vartëse në diskutimet për planin strategjik? Po palët e treta? (si p.sh.: organizimi i tryezave të rrumbullakëta me subjekte të tjera Publike, shoqërinë civile, akademike). Jepni referenca të minutave të takimit apo komunikimeve shkresore. Lloji i Vlerësimit I . Vlerësim me 2 pike nëse ka pasur vetëm diskutim të brendshëm.

-Gjate hartimit te strategjise kemi pasur diskutim te brendshem.

2

Pyetja: 13 A llogaritet kostoja e strategjisë? (Nëse Po, duhet të tregohet në dokumentin e strategjisë, pjesa e burimeve financiare. Lloji i Vlerësimit I

- Jemi ne proces te hartimit te strategjise.

1

Pyetja: 14 A dërgohet plani strategjik varësisht prej llojit të subjektit (qendrore ose lokale) në sistemin e planifikimit strategjik të Zyrës së Kryeministrit ose në Ministrinë e Pushtetit Lokal? (jepni referencat e shkresës së dërgimit në Kryeministri ose Ministrinë e Pushtetit Lokal). Lloji i Vlerësimit II

- Po dergohet ne zyren e kryeministrit por AMMKM eshte ne proces te hartimit te planit strategjik.

1

Pyetja: 15 A i përcakton SSP treguesit e performancës në planin strategjik për monitorimin e arritjen së objektivave? (Nëse Po, duhet të jetë përcaktuar në dokumentin e strategjisë, në mënyrë narrative ose në matricën shoqëruese). Lloji i Vlerësimit II

- Jemi ne proces te hartimit te strategjise.

1

Pyetja: 16 A janë informuar menaxherët/punëtorët e SSP në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë pas miratimit të tyre? (Specifikoni cila ka qenë mënyra dhe data e shpërndarjes së dokumenteve, p.sh. në formë elektronike me email, në formë shkresore, minuta takimi, etj.). Lloji i Vlerësimit II

- AMMKM ende nuk e ka te miratuar strategjine dhe rrjedhimisht nuk i ka informuar menaxheret/punetoret.

1

Pyetja: 17	A keni plan-veprime vjetore të miratuara, për arritjen e qëllimeve strategjike, objektivave vjetore që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar? (Ky duhet të jetë një dokument i miratuar nga kryesuesi i subjektit). Lloji i Vlerësimit I - Kemi planin vjetor të performances i cili përcakton objektivat dhe departamentet përgjegjëse për realizim të tyre.	2
Pyetja: 18	A është struktura e organizatës suaj e përshtatshme për karakterin e aktivitetit të saj? (Nëse të gjitha funksionet që i janë caktuar subjektit me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi janë adresuar në të gjithë strukturën e subjektit, nëse kjo strukturë është e centralizuar, apo e decentralizuar me zyra territoriale/agjensione). Lloji i Vlerësimit I - Po.	3
Pyetja: 19	A përfshin organogrami (e publikuar) i SSP edhe zyrat e ofiqarisë /agjensione/njësitë e vartësisë/ndërmarrjet që janë në pronësi ose me pjesëmarrje në kapital? (Pyetja ka të bëjë me faktin se shpeshherë organogrami i publikuar përmban vetëm organiken e administratës së përgjithshme organit qendror, duke përfshirë njësitë e vartësisë. Në këtë mënyrë nuk del qartë lidhja mes tyre dhe linjat e raportimit). Lloji i Vlerësimit II - Nuk kemi njësi vartese.	3
Pyetja: 20	A është organogrami në gjendje t'ju ofrojë informacionin e nevojshëm për vendimmarrjen tuaj? (të jenë të qarta linjat e përgjegjësisë dhe të raportimit në mënyrë që informacioni të mos vije i copëzuar ose i pakoordinuar nga departamente të ndryshme) Nëse Jo përshkruani problemin dhe nëse përmirësimi lidhet me vendimmarrjen tuaj apo kërkohej ndërhyrje me lart. Lloji i Vlerësimit II - Po	3
Pyetja: 21	A ka çdo departament / drejtori / divizion apo njësi, përgjegjësi dhe detyra të përcaktuara qartë dhe veçmas nga drejtoritë/ departamentet/ sektorët e tjerë. (Nëse po, lutemi specifikoni se në cilin dokument janë përshkruar këto përgjegjësi.) Lloji i Vlerësimit I - Po, në bazë të rregullores së brendshme me nr 01/2019 për sistematizimin e vendeve të punës.	3
Pyetja: 22	A janë përcaktuar përgjegjësitë e menaxherëve në mënyrë të qartë sipas kontratës së punës? Lloji i Vlerësimit II - Po	3

Parimi 4 – Zotimi për kompetencë

Pyetja: 23	A kanë menaxheret njohuritë e duhura dhe eksperiencën për të përmbushur përgjegjësitë e tyre? Nëse Jo cilat do të ishin disa drejtime ku kërkohej kualifikim i mëtejshëm? Vlerësimi me 2 pike nëse kërkohej kualifikime të mëtejshme në disa drejtime; Vlerësim me 1 pike nëse ka dobësi të theksuara që kanë ndikim të konsiderueshëm në realizimin e objektivave, Lloji i Vlerësimit I - Po	3
Pyetja: 24	A janë menaxherët e programeve buxhetore (sipas tabelave të ligjit të buxhetit) në varësi direkt administrative të ZKA? Vlerësim me 2 pike nëse vetëm një pjesë e menaxhereve plotësojnë kriterin. Lloji i Vlerësimit I - Po	3
Pyetja: 25	A keni miratuar ju përshkrime pune për çdo pozicion pune në SSP, në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit? (kjo pyetje lidhet me punonjësit e të gjitha niveleve në SSP dhe përfshin edhe drejtuesit e lartë). Lloji i Vlerësimit I - Po	3
Pyetja: 26	A ka ndonjë analizë me shkrim të njohurive dhe aftësive që duhen për të përmbushur punën në procesin e rekrutimit të stafit në vende të reja pune ose për shtimin e detyrave/funksioneve të reja në vendet ekzistuese të punës? Lloji i Vlerësimit I - Po	3

